



**AKT THEMELIMI - STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“MADINAH” shpk**

Sot me datë 16 nëntor 2021, ne, ortakët themelues:

1. **Bledar Ali**, atësia Bardhul, amësia Shpresa, shtetas Shqiptar, lindur në Delvinë dhe banues në adresën Lagjia Sinan Ballaci; Nd. 029; H. 00; Ap. 000; Delvinë; Delvinë; 9704; Delvinë, i datëlindjes 06/02/1979, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës I Letërnjoftimit ID nr. 035962517 dhe nr. personal H90206044U.
2. **OMAR SALEH O. ALZUGHAIBI**, atësia Saleh, amësia Aishah, shtetas arab, lindur në Alkabra, Arabia Saudite dhe banues në Arabi Saudite, me adresë Rabaeh Bin Darraj Al Jumahi, Aljamiah Dist, Al Madinah, Al Munawwarah 42351, Dmmb6729, lindur më 31/05/1946, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte nr. V451828. Përfaqësuar me prokure te posaçme me nr 1940 rep nr. 961 kol date 22.10.2021 nga **Bledar Ali**, atësia Bardhul, amësia Shpresa, shtetas Shqiptar, lindur në Delvinë dhe banues në adresën Lagjia Sinan Ballaci; Nd. 029; H. 00; Ap. 000; Delvinë; Delvinë; 9704; Delvinë, i datëlindjes 06/02/1979, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës I Letërnjoftimit ID nr. 035962517 dhe nr. personal H90206044U.

Me vullnetin tonë të plotë, kemi vendosur si më poshtë vijon:

**KREU I**

**NENI 1**

Të themelojmë shoqerinë me përgjegjësi të kufizuar **me emrin: “MADINAH” Sh.P.K** (që këtu e më poshtë do të quhet shoqëria), me seli në Lagjia Sinan Ballaci; Nd. 029; H. 00; Ap. 000; Delvinë; 9704; Delvinë.

**NENI 2**

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve të këtij akt themelimi, statutit, Ligjit nr. 9901, dt. 14.04. 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"; si dhe Ligj nr.129/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtaret dhe Shoqëritë tregtare".

### **NENI 3**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

*Investime ne: bujqësi, krijim te fermave bujqësore dhe blegtorale, shit-blerje te pasurisë toke bujqësore, import- eksport te produkteve bujqësore dhe blegtorale, përpunim i produkteve bujqësore dhe blegtorale, ambalazhimin e tyre, turizëm, agroturizëm etj. Shoqëria do te kryeje aktivitet edhe për: importimin dhe eksportimin e materialeve te ndryshme.*

### **NENI 4**

Kapitali i regjistruar i shoqërisë përbëhet nga kontributet në para dhe është në shumën 100.000,00 lekë (njeqind mijë). Ky kapital është i ndarë në 1(nje) kuota, dhe pjesmarrja e ortakëve themelues në kapitalin e shoqërisë është si vijon:

Ortaku themelues: **Bledar Ali**, zotëron 50 (pesëdhjetë) % te kuotës, dhe .

Ortaku themelues: **Omar Saleh O. Alzugaibi**, zotëron 50 (pesëdhjetë) % te kuotes.

### **NENI 5**

#### **Administratori**

Administrator i shoqërisë për një periudhë kohe pese vite, të jetë: Zoti **Bledar Ali**, atësia Bardhul, amësia Shpresa, shtetas Shqiptar, lindur në Delvinë dhe banues në adresën Lagjja Sinan Ballaci; Nd. 029; H. 00; Ap. 000; Delvinë; Delvinë; 9704; Delvinë, i datëlindjes 06/02/1979, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit ID nr. 035962517 dhe nr. personal H90206044U.

### **KREU II**

#### **STATUTI**

Statuti rregullon pozitën juridike të themeluesve dhe punonjësve në shoqëri, të dhënat me rëndësi për qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarisë dhe çështje të tjera me rëndësi për funksionimin e shoqërisë. Shoqëria ka vulën e saj në formë të drejtkëndore me madhësi të zakonshme ku shkruhet Shoqëria "**MADINAH**" **Sh.P.K.** Shoqëria kryen veprimtarin e saj për të realizuar fitimin e saj duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe të rentabilitetit.

### **NENI 6**

Shoqëria përgjigjet për detyrimet e saj me fondet e veta.

### **KREU III**

#### **Të drejtat dhe detyrat e Ortakut:**

#### **NENI 7**

##### **Ortaku gëzon këto të drejta kryesore:**

1. Pjesëmarrjen në rezultatet e çdo forme dhe sasie të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj.
2. Marrjen e të gjithave të dhënavë që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarinë e shoqërisë, si dhe me të gjithë dokumentet e përpunuara nga shoqëria, bilancet si dhe llogaritë ekonomike, etj.
3. Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblesë së Ortakeve.
4. Të heqë dorë nga shoqëria.
5. Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj shoqërisë.
6. Të marre pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose vetë.
7. Të kërkoje t'i jepen të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen prodhuese dhe tregtare të shoqërisë, si dhe të gjithë dokumentet e përpunuara të shoqërisë, si bilancet, llogaritë ekonomike, etj.
8. Të bëjë propozime dhe ti paraqesë ato për shqyrtim para organeve të shoqërisë.
9. Të emërojë dhe të shkarkojnë përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

#### **NENI 8**

##### **Ortaku ka këto detyrime kryesore:**

1. Të depozitojë kuotën e tij dhe kuotat suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
2. Të marre pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vete ai.
3. T'i japi shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e çdo objekti të veçantë lidhur me veprimtarinë e saj.
4. Të kryeje detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.

5. Ortaku ka të drejtë të heqë dorë nga shoqëria, duke i njofuar vendimin e tij asamblesë së ortakeve në rast shtimi të ortakëve 6 muaj përpara dhe duke ceduar te drejtën e zgjedhjes.
6. Heqja dorë nuk e liron ortakun nga detyrimet e marra me parë ndaj shoqërisë dhe nuk pezullon detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut.
7. T'i japë shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
8. Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.
9. Pjesëmarrja në shoqëri nuk i pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore për veprimtari të tjera dhe për të drejtat e tjera pronësie. Ai nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë që rrjedhin nga objekti i veprimtarisë së saj tej kapitalit themelor ku ata kanë marrë pjesë.



#### **KREU IV**

#### **Kushtet Ekonomike**

#### **NENI 9**

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të leverdisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancet e saj. Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brenda 31 Marsit të vitit pasardhës. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

#### **NENI 10**

Llogaritë vjetore, inventari, raportet, operacionet e veprimtarisë së vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar miratohen nga Asambleja. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes vitit financiar.

#### **NENI 11**

Për të bërë të mundur zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë, vihet një kapital bazë që përbën burimin fillestare për krijimin e fondit themelor dhe të mjeteve të xhiros.

#### **NENI 12**

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave e marrin ortaket themelues. Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten të gjitha detyrimet si edhe fondet e lëna rezervë për nxitjen ekonomike, për investime, për reklamën tregtare, përfitohen prej ortakeve themelues të kësaj shoqërie. Ortaku përballon humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së tyre të derdhur nëpërmjet shtimit të tij. Ortakët kanë të drejtën e rritjes së tij. Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, shitblerje, dhurim. Në rast ndarje pasurie ndërmjet

bashkëshorteve dhe nëpërmjet paraardhësve, *transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohet me akt notarial*. Shoqëria në emër të vet është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj, por gjithmonë në përputhje me qëllimin e objektin e veprimtarisë që ajo kryen. Shoqëria mund të shesë pasuri ose të shfrytëzoj të drejta të tjera materiale. Ajo mund të ofrojë për garanci edhe pasuri të saj për të marrë kredi bankare. Shoqëria krijon fonde rezevë ose dhe fonde të tjera të veçanta për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të saj.

### **NENI 13**

Shoqëria është pronare e pasurive të saj dhe ka të drejtë të përdorimit dhe disponimit të kësaj pasurie, në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë që kryen. Shoqëria gëzon të drejtat për mbrojtjen e pasurisë së saj në përputhje me legjislacionin shqiptar.

### **NENI 14**

E ardhura bruto e shoqërisë pasi zbritet amortizimi i të gjithë pasurisë së luajtshme e të paluajtshme sipas afateve të caktuara, kuotat që kanë të bëjnë me kreditë për investimet, pagat e shtesat mbi pagat, shpenzimet për lëndët e para apo ndihmëse për energjinë si dhe shpenzimet e përgjithshme të seksioneve të shoqërisë dhe ato për qëllime të tjera prodhuese e joprodhuese, i takon ortakeve të shoqërisë.

### **KREU V**

#### **Administrimi**

### **NENI 15**

#### **Organi vendimor i shoqërisë është**

#### **Asambleja e Ortakëve.**

Mbledhja e Asamblesë mund të thirret nga administratori dhe nga eksperti kontabël i autorizuar.

#### **Asambleja vendos:**

1. Për çështje të tillë si emërim ose shkarkimin e personelit teknik sipas strukturave tëngritura nga shoqëria, ekspertit kontabël të autorizuar dhe likuiduesit dhe miratimin e raporteve të administrimit dhe kontrollit.
2. Miratimin e programit vjetor të veprimtarisë së shoqërisë.
3. Përfitimin dhe rezultatet.

4-Për çështje të tillë si ndryshimin e statutit, zvogëlimin e pjesëve të kapitalit themeltar, zmadhimin e kapitalit themeltar, transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar, shndërrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në forma të tjera ose mbylljen e shoqërisë para kohe. Asambleja thirret së paku një herë në vit, duke lajmëruar me shkrim 30 ditë përpara.

## NENI 16

### Kompetencat ekzekutive të Asamblesë së Ortakeve të shoqërisë janë:

1. Përcaktimi i të drejtave kryesore të veprimtarisë së shoqërisë.
2. Ndryshimet në emërtesen e prodhimit që do të realizohet dhe të punimeve që do të kryhen, që janë pjesë përbërëse e objektit të veprimtarisë së shoqërisë.
3. Propozimet e nevojshme për ndryshimet në kapitalin bazë të shoqërisë.
4. Përcaktimi i regjimit dhe i kushteve të zbatimit të parimeve të llogarisë ekonomike.
5. Përcaktimi i rregullave dhe i normave, që përkufizojnë raportet me gjirin e shoqërisë, duke përfshirë dhe kuadrin e personelit.
6. Përcaktimi i strukturës së aparatit të shoqërisë.
7. Përcaktimi i organikës dhe ndarja e vendeve drejtuese ndërmjet përfaqësive të ortakëve.
8. *Emeron dhe shkarkon Administratorin e përgjithshëm të shoqërisë.*
9. Krijimi i organeve të tjera të domosdoshëm për realizimin e objektivave të shoqërisë.
10. Përcaktimi i madhësisë së kuotave për formimin e kapitalit bazë të shoqërisë.
11. Paraqitura e propozimeve për rregullimin, krijimin dhe përfitim nga fondet e veçanta, ndarjen e fitimeve dhe përcaktimi i rregullave për shlyerjen e borxheve.
12. Marrja e vendimit për krijimin e filialeve të degëve e të përfaqësive si dhe përcaktimin e veprimtarisë së tyre.
13. Përcaktimi i rregulloreve për procedurën e punës të administratës.
14. Përgatitja e propozimit për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë.
15. Përzgjedhja e anëtarëve për komisionin e likuidimit të cilët emërohen dhe revokohen nga Asambleja e Ortakeve.
16. Kryerjen e veprimtarive për likuidimin e llogarive, që i përkasin ortakut te dorëhequr të shoqërisë.
17. Marrjen e vendimit për kërkimin dhe përdorimin e kredive afatgjata

## NENI 17

Veprimtaria e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj. Në shoqërinë "**MADINAH**" SH.P.K Administrator i shoqërisë do të jetë Zoti **Bledar Ali**, atësia Bardhul, amësia Shpresa, shtetas Shqiptar, lindur në Delvinë dhe banues në adresën Lagjia Sinan Ballaci; Nd. 029; H. 00; Ap. 000; Delvinë; Delvinë; 9704; Delvinë, i datëlindjes 06/02/1979, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit ID nr. 035962517 dhe nr. personal H90206044U.

Administratori Bledar Ali, ka në të njëjtën kohe edhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretët në gjithë veprimtarinë e saj. Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej pesë vjetësh financiare me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose shkarkimit të parakohshëm. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk I njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.

## **Kompetencat e administratorit në shoqëri janë:**

1. Të miratoje planet e llogarive ekonomike pas përfundimit të tyre në kuadrin e veprimtarisë së shoqërisë.
2. Të bëjë propozimet e nevojshme në mbledhjen e asamblesë kur lind nevoja e *ndryshimit te kapitalit themeltar* të shoqërisë.
3. Të miratoje akte normative që përcaktojnë organizimin e shoqërisë, përfshirë emërimin dhe shkarkimin e personelit.
4. Të përcaktojë strukturën administrative të shoqërisë.
5. Të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
6. Të propozojë në mbledhjen e asamblesë për krijimin e njësive dhe strukturave si filiale, degë e përfaqësi në qytetet e tjera të vendit apo dhe jashtë shtetit.
7. Të përgatisë propozimet për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe tija paraqesin ato Asamblesë për miratim.
8. Të përzgjedhë ekspertet kontabël dhe anëtarët e komisionit të likuidimit dhe të paraqesin propozimet për miratim në asamble.
9. Të sigurojë zbatimin e përpiktë të vendimeve të asamblesë.
10. *Të përcaktojë numrin e punonjësve të shoqërisë dhe pagat e tyre.*
11. Te organizoje punën për realizimin e planeve të shoqërisë dhe raporton për to në përputhje me programet e planet e përgjithshme, administron pasurinë e shoqërisë, duke përfshirë këtu mjetet financiare, brenda caqeve të vendimeve të marra nga organi administrative i shoqërisë. Drejton e kontrollon veprimtarinë e filialeve, të degëve e të përfaqësive. Përfaqëson shoqërinë përrpara të tretëve si gjykatë, etj. Nënshkruan kontrata në emër e përllogari të shoqërisë dhe siguron vënien e tyre në jetë.
12. Te marre të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me ato veprimtari të shoqërisë, që nuk janë në kompetencë ekzekutive të Asamblesë së Ortakeve.
13. Të nënshkruaje marrëveshjet me shoqëri të tjera Shqiptarë apo të huaja për marrje pjese në tendera apo në koncesione.
14. Raporton dhe i përgjigjet Asamblesë për zbatimin e veprimtarive të shoqërisë si dhe përealizimin e objektivave dhe detyrave që janë në kompetencë të tij. Siguron drejtimin e shoqërisë.
15. Përfaqëson shoqërinë në lidhje me të tretët brenda caqeve të objektit të veprimtarisë së saj, përvèç çështjeve që kërkojnë unanimi tetin e ortakëve ose që kanë të bëjnë me kompetencat që ky statut i atribuon Asamblesë së Ortakeve. Organizon zbatimin e saktë të vendimeve të Asamblesë së Ortakut.

## **NENI 18**

Për të kontrolluar veprimtarinë financiare të shoqërisë e të filialeve të saj krijohet komisioni I revizionimit kontabël. Kryetari dhe anëtaret e këtij komisioni emërohen nga Asambleja e Ortakeve. Kryetari i komisionit emërohet për çdo mandat nga Asambleja. ***Komisioni i Revizionimit kontabël përbëhet nga 3-5 vetë dhe qëndron në detyre për një periudhe prej tre vjetësh.*** Kryetari dhe antarët e komisionit nuk mund të jenë në varësi të shoqërisë ose filialeve të saj. Komisioni i Revizionimit kontabël është përgjegjës për veprimtarinë e vet përrpara Asamblesë së Ortakëve dhe është i detyruar t'i paraqesë asaj çdo vit raport për kontrollet e bëra si dhe konkluzionet për bilancet vjetore.



## NENI 19

### Marrëdhëni e punës në shoqëri

Marrëdhëni e punës në shoqëri e filiale, në degë e përfaqësuesit rregullohen në përputhje me vendimin për krijimin e shoqërisë, legjislacionit shqiptar dhe me këtë statut si dhe nëpërmjet

kontratës së punës. Për çështjet që nuk rregullohen në kontratën e punës, zbatohen dispozitat e legjislacionit të punës. Punësimi i punonjësve në shoqëri bëhet mbi bazën e kontratës kolektive dhe individuale të punës. Në kontratën e punës rregullohen këto çështje: Kushtet dhe mënyra e marrëdhënieve së punës. Fillimi i punës së punonjësve dhe caktimi i tij në vendin e punës. Koha e punës dhe caktimi I kohës së punës, puna e natës, puna sezionale, puna jashtë kohës normale, puna në ditët e pushimit favor dhe festat zyrtare. Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës. Pushimet dhe mungesat, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e punonjësve për zbatimin e detyrave të punës. Pushimi i marrëdhënieve së punës. Paga e punës së punonjës, shpërblimi i punës dhe shpërblimet dhe të tjera. Shoqëria merr përsipër të bëjë sigurimin e të punësuarve pranë saj në organet përkatëse duke derdhur rregullisht kontributet në përqindjet caktuara sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent për shqyrtimin e tyre është Gjykata e rrëthit Gjyqësor Sarandë.



## KREU VI

### Prishja e Shoqërisë

## NENI 20

Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin të *secilit prej ortakëve*, kur gjatë 5 vjetëve nuk rezulton rentabël ose kur ortaku heq dorë nga shoqëria si dhe të gjitha rastet që parashikohen në dokumentet e krijimit të shoqërisë. Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likuidimi. *Afati i veprimtarisë së shoqërisë caktohet i pakufizuar.*

## NENI 21

### Kur shoqëria likuidohet

Asambleja e ortakeve emëron likuidatorin, të cilin i paraqitet bilanci dhe shoqëria i jep fund veprimtarisë së saj ne çastin e miratimit të këtij raporti të hartuar. Pasuritë që janë venë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi, shiten në vartësi të shkallës së konsumit të tyre. Të ardhurat cedohen ndërmjet ortakeve në përpjesëtim me kuotën e venë. Mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë e të filialeve të saj dhe fondet financiare ndahan ndërmjet ortakeve në përpjesëtim me kuotat e vëna, pasi të jenë bërë pagesat për kreditoret.

**NENI 22**

Ky akt themelimi dhe statut është i hartuar ne katër kopje te barasvlereshme nga ana ligjore dhe hyjnë në fuqi menjehë.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

“MADINAH” Sh.P.K

Bledar Ali

**Omar Saleh O. Alzughabi**

*Bledor Ali*

*MS*

Përfaqësuar nga

*Bledor Ali*

*MS*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE GJIROKASTËR  
NOTER LAURETA I. TARE**



V2021021830108026738

**DATE 16/11/2021  
NR REP 2124**

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 16.11.2021, para meje Notere LAURETA I. TARE, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore GJIROKASTËR, me zyrë në adresën Sarande, NR.1, ONHEZMI, NR.267, NR.1, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUESIT:**

**1-Bledar Ali**, atësia Bardhul, amësia Shpresa, shtetas Shqiptar, lindur në Delvinë dhe banues në Delvinë, me adresë Lagjia Sinan Ballaci; Nd. 029; H. 00; Ap. 000; Delvinë; Delvinë; 9704; Delvinë, lindur më 06/02/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035962517 dhe nr. personal H90206044U .

**2-OMAR SALEH O. ALZUGHAIBI**, atësia Saleh, amësia Aishah, shtetas Shqiptar, lindur në Alkabra Arâbia saudite dhe banues në Arabi Saudite, me adresë Rabaeh Bin Darraj Al Jumahi, Aljamiah Dist , Al Madinah, Al Munawwarah 42351, Dmmb6729, lindur më 31/05/1946, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. personal V451828 . Përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e posaçme" me Nr. Rep 1940, Nr. kol 961, hartuar nga noter Laureta Tare, në datë 22/10/2021, nga përfaqësues **Bledar Ali**, atësia Bardhul, shtetas shqiptar, lindur në Delvinë dhe banues në Delvinë, lindur më 06/02/1979, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga karta e identitetit me nr. personal H90206044U.

Z. Bledar Ali nenshkroi me vullnet të lirë dhe të plotë, edhe ne cilesine e perfaqesuiist me prokure te **Z. Omar Saleh O. Alzughabi**, u paraqiten dhe nënshkruan përpara meje Noteres, " Akt themelimi -Statut i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MADINAH", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gëрма "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

LAURETA I. TARE

